



REPUBLIKA E SERBISË
MBROJTËSI I QYTETARËVE

16-2568/11
B e o g r a d



Mbrojtësi i qytetarëve

nr.ref. 14779 data: 18.06.2012.

Në bazë të nenit 138 Paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë ("Gazeta Zyrtare e RS-së", nr. 98/06) gjegjësisht nenit 1 paragrafi 2, nenit 31 paragrafit 2 dhe Nenit 32 Paragrafi 1 të Ligji për Mbrojtësin e qytetarëve ("Gazeta Zyrtare e RS-së", nr. 79/05 dhe 54/07), në procedurën e kontrollit të ligjshmërisë dhe rregullsisë së punës së Ministrisë së Kulturës, Informimit dhe Shoqërisë së Informacionit, me iniciativën e vet, Mbrojtësi i qytetarëve

KONSTATON

Në punën e Ministrisë së Kulturës, Informimit dhe Shoqërisë së Informacionit ka identifikuar mangësitë në vijim:

- Ministria nuk ka ofruar siguri ligjore në zbatimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave dhe zbatimin e masave të mbrojtjes dhe realizimin e së drejtës për informim të pakicave të kombësisë shqiptare, boshnjake, bullgare dhe rome, pasi për periudhën prej vitit 2009 deri 2011, për çdo vit ka ndryshuar mënyrën e bashkë-financimit të mirëmbajtjes së gazetave në gjuhët e këtyre pakicave kombëtare;

- Me ndërprerjen e tërësishme të bashkë-financimit të mirëmbajtjes së të paktën një gazete në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome, në vitin 2012, (dhe kjo për shkak të zbatimit të Strategjisë për Zhvillimin e sistemit të informimit publik), është shkelur e drejta kushtetuese dhe ligjore që garanton trajtim të barabartë dhe mbrojtje ligjore të pjesëtarëve të këtyre pakicave kombëtare, e që ushtrohen nga pjesëtarët e pakicave në krahinën autonome të Vojvodinës.

Zbatimi i strategjisë për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Publik për punën e Ministrisë, në pjesën ku ndalohet pjesëmarrja e gazetave në konkurset publike (por edhe mediave të tjera publike), të cilët janë themeluar nga këshillat kombëtare të pakicave, e të cilët paraprakisht nuk kanë siguruar bashkë-financimin e tyre nga mjetet e buxhetit mbi baza të tjera, është e paligjshme, sepse i vënë ata në një pozitë të pabarabartë në krahasim me mediat e tjera publike në bazë të së drejtës së themelimit.

Në përputhshje me parimet e qeverisjes së mirë, Ministria, para se të marrë vendimin me të cilin tërësisht ndryshohet mënyra shumë-vjeçare e punës dhe bashkë-financimit të gazetave në gjuhët e pakicave me mjetet e buxhetit të shtetit, nuk është konsultuar dhe nuk ka njoftuar këshillat kombëtare të pakicave dhe ministrinë përkatëse për çështjet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, që në vitin 2012 do të ndalojë tërësisht bashkë-financimi i gazetave në gjuhën e pakicave.

Në mënyrë që të eliminojë parregullsitë dhe paligjshmëritë e përcaktuara në punë dhe pasojat e saj, Mbrojtësi i qytetarëve parashtron

REKOMANDIMET

Ministria e Kulturës, Informimit dhe Shoqërisë së Informacionit, pa vonesë, në përputhje me përgjegjësitë e saj:

1. Të miratojë Vendim apo të propozojë miratimin e tij qeverisë së RS me të cilin do të rregullojë në mënyrë ligjore vazhdimin e bashkë-financimit të mirëmbajtjes e të paktën një gazete në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome, në përputhje me obligimet e parapara në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, dhe me synim të mbrojtjes dhe realizimit të barabartë të të drejtave të pakicave në Republikën e Serbisë, dhe me aktin e përmendur do të rregullojë edhe realizimin dhe mirëmbajtjen e të paktën një gazete në gjuhët e pakicave të tjera etnike, të cilët këtë të drejtë nuk e gëzojnë në krahinën autonome të Vojvodinës.
2. Është e nevojshme që Ministria e Kulturës, Informimit dhe Shoqërisë së Informacionit t'i propozojë Qeverisë së RS-së, ndryshimet dhe plotësimet në strategjinë e zhvillimit të sistemit të informimit publik, ashtu që të parashihet, që në konkursin publik në fushën e informacionit nuk mund të marrin pjesë mediet publike, të cilët janë themeluar nga këshillat nacionale të pakicave, vetëm nëse kryesisht apo në pjesë domethënëse nuk bashkë-financohen me mjetet e buxhetit nga baza të tjera.
3. Në procesin e hartimit dhe miratimit të një akti të tillë, Ministria e Kulturës, Informimit dhe Shoqërisë së Informacionit, si organi përkatës qeveritar, do të ketë parasysh zgjidhjet e mundshme në krahinën autonome të Vojvodinës dhe patjetër të sigurojë pjesëmarrjen e këshillave nacionale të pakicave (baza e të cilëve është në Serbinë qendrore), në pajtim me nenin 10 të Ligjit për këshillat nacionale të pakicave, ndërsa mjetet e nevojshme për bashkë-financim të mirëmbajtjes së mëtejme dhe publikimin e rregullt të gazetave në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome, të planifikojë në rishikimin e parë të buxhetit të shtetit.

Ministria e Kulturës, Medies dhe Shoqërisë së Informacionit, brenda 30 ditëve të njoftojë Mbrojtësin e qytetarëve për masat e marra dhe të planifikuara, dhe jo më vonë se 60 ditë nga dita e pranimit të këtij rekomandimi, të njoftojë mbi veprimet e ndërmarra sipas tij.

A r s y e t:

Me konstatimin e mangësive në punën e Ministrisë së Kulturës, Medies dhe Shoqërisë së Informacionit (në tekstin e mëtejme Ministria) Mbrojtësi i qytetarëve vlerësoi faktet dhe dokumentet që janë mbledhur gjatë procedurës të udhëhequr me vetiniciativë dhe gjatë hulumtimit mbi realizimin e të drejtave të pakicave për informim në gjuhën e tyre që e ka realizuar në vitin 2011, e të cilat i kanë paraqitur Ministria, Sekretariati Krahinor i Kulturës dhe Informimit Publik, këshillat nacionale të pakicave dhe Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, Administratë Publike dhe Vetë-Qeverisje Lokale - Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave.

I

Ministria, duke vepruar në bazë të kërkesës së Mbrojtësit të qytetarëve, më 6 qershor, 26 korrik dhe 4 nëntor 2011, ka paraqitur të dhënat, informacionet shtesë dhe dokumentet, lidhur me masat e ndërmarra të cilat i ndërmerr nën juridiksionin e saj për realizimin e të drejtave për informim të nacionaliteteve me pakicë kombëtare në gjuhën e tyre.

Në bazë të informatave dhe dokumenteve të pranuar në lidhje me punën e Ministrisë dhe zbatimin e masave të mbështetjes financiare nga buxheti shtetëror për gazeta¹ në gjuhët e pakicave kombëtare, në periudhën 2009-2011, Mbrojtësi i qytetarëve konstatoi si më poshtë:

1. Ministria në vitin 2006, në përputhje me angazhimet e ndërmarra me instrumentin e ratifikimit të Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (në tekstin e mëtejshëm Konventa Evropiane), **ka filluar me bashkë-financimin e botimit të gazetave** në gjuhën shqipe, boshnjake dhe rome - "Perspektiva", "Boshnjačka riječ" (më vonë "Sanxhaqke novine") dhe "Romano Nevipe". Të drejtën për të publikuar gazetën, "Bratstvo", në gjuhën bullgare, pakicat bullgare e kanë ushtruar në bazë të Ligjit për themelimin e institucionit gazetar-botues "Bratstvo" ("Gazeta Zyrtare RS", nr. 53/95), i cili u shfuqizua në vitin 2006;

2. Ministria deri në vitin 2009 ka bashkë-financuar botimin e këtyre gazetave **jashtë e procedurave të konkursit**, përmes subvencioneve. Ministria në bazë të nenit 5 të Ligjit për informim publik lëshoi një vendim të veçantë në lidhje me ndarjen e fondeve për gazeta në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome. Në arsyetim të vendimit është cekur se me ratifikimin e Kartës Evropiane, Republika e Serbisë mori përsipër detyrën për botimin e të paktën një gazete në gjuhët të cilët i ka ndërmarrë me instrumentin e ratifikimit. Në bazë të këtyre vendimeve janë nënshkruar marrëveshje për bashkë-financim për gazetatat e lartpërmendura në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome;

3. Në vitin 2010 Ministria **ka shpallur një konkurs të veçantë për bashkë-financim të gazetave në gjuhët e pakicave kombëtare në Serbinë qendrore**, me qëllim "që të inkurajojë ose lehtësojë krijimin dhe mirëmbajtjen e të paktën një gazete në gjuhët rajonale ose të pakicave". Siç u tha nga Ministria, arsyeja për ndryshim të mënyrës së deritanishme të punës është që me hapjen e konkursit iu është dhënë mundësia edhe gazetave tjera në gjuhët e pakicave kombëtare për të marrë pjesë në konkurs. Pas përfundimit të konkursit bashkë-financohen gazeta të njëjta në gjuhën boshnjake, bullgare dhe rome, ndërsa shqyrtimi i botimit të gazetës në gjuhën shqipe është shtyrë derisa aplikuesit nuk i plotësojnë kërkesat formale të konkursit;

4. Në vitin 2011, ministria sërish e ka ndryshuar mënyrën e punës dhe e **ka shpallur një konkurs të unifikuar për bashkë-financimin e projekteve/programeve në fushën e informimit publik në gjuhët e pakicave kombëtare**. Qëllimi i konkursit është zgjeruar "me mbështetjen e botimit e të paktën një gazete në gjuhët e pakicave". Duke shqyrtuar procesverbalin e mbledhjes së Komisionit që ka vendosur për projektet që kanë marrë pjesë në këtë konkurs, të cilin Ministria e ka paraqitur me kërkesë të Mbrojtësit të qytetarëve, është vërejtur se zyrtarët e Ministrisë është dashur që anëtarëve të Komisionit t'i bëjnë me dije se me këtë konkurs janë të përfshirë edhe projektet e gazetave në gjuhët e pakicave dhe se "edhe pse këto projekte janë vendosur në të njëjtën kategori me projekte të tjera, në përputhje me detyrimet e Kartës Evropiane, ekziston një arsye serioze për dhënien e fondeve më të mëdha se sa të tjerëve". Komisioni paraprakisht i ka shqyrtuar projektet e gazetave që janë mbështeten nga Këshilli Kombëtar, ose vet i kanë paraqitur si projektet e tyre. Me vendimin e Ministrisë të Kulturës, fondet janë të shpërndara gazetave të njëjta, në gjuhën boshnjake, bullgare dhe rome dhe listës "Nacionali", në gjuhën shqipe, themeluesi e të cilës është Këshilli Kombëtar i pakicës shqiptare, i cili për herë të parë është themeluar në vitin 2010.

Me kërkesë të Mbrojtësit të qytetarëve për sigurimin e kopjes së akteve me të cilin rregullohet mënyra, kriteret dhe standardet e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit për informim në gjuhët e pakicave kombëtare, **Ministria e ka informuar këtë organ se nuk ka sjellë ndonjë akt që rregullon mënyrën, kriteret dhe standardet e mbështetjes financiare për informim në gjuhët e pakicave kombëtare, sepse dispozita e nenit 5 Ligji mbi informimin publik prej nga edhe bazohet, nuk përmban ndonjë dispozitë në bazë të cilës mund të sjellë një akt të tillë.**

Duke pasur parasysh të gjitha thëniet e mësipërme, nuk ka dyshim se Ministria, në kundërshtim me parimet e qeverisjes së mirë të cilat obligojnë që gjatë zbatimit të rregullave

¹ Për qëllime të rekomandimit, për mediat e shtypura publik është përvetësuar termi gazeta

dhe masave të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të njeriut dhe të pakicave, të ofrojë siguri ligjore, çdo vit nga viti 2009 deri në vitin 2011 ka ndryshuar mënyrën dhe kriteret e mbështetjes financiare për botimin e rregullt dhe mirëmbajtjen e gazetës në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome.

Procedurat me të cilat vendoset mbi të drejtat, obligimet dhe interesat e qytetarëve dhe subjekteve juridike rregullohen me ligj ose rregullore dhe me aktet e përgjithshme të bazuarë në ligj dhe në përputhje me ligjin. Lëshimi i organit që të krijojë rregulla për procedurat e veta (në qoftë se ata nuk janë të përcaktuara me ligj ose akt nënligjor) dhe zhvillimi i procedurave pa parimet e qarta dhe rregullave ligjore përbëjnë veprimet e keqadministrimit, krijojnë pasiguri ligjore dhe krijojnë vend për arbitraritetin në vendim-marrje.

II

Në rastin e vendimit mbi këtë çështje, Mbrojtësi i qytetarëve mori parasysh informatat dhe dokumentet me të cilat, me kërkesën e këtij organi, i dorëzoi Sekretariati Krahinor i Kulturës dhe Informimit Publik, dhe atë:

1. Në krahinën e Vojvodinës, bashkë-financimi i mirëmbajtjes dhe botimi i rregullt i gazetës në gjuhët e pakicave kombëtare rregullohet me vendim për sigurimin e fondeve nga buxheti i shtetit të Krahinës Autonome të Vojvodinës për botimin e gazetave me rëndësi të krahinës². Me vendim, taksativisht janë numëruar të gjitha botimet që botohen në krahinën e Vojvodinës në gjuhët tradicionale të pakicave kombëtare, dhe ato në gjuhën hungareze, sllovaqe, ruse, ukrainase, rumune, kroate, por edhe në gjuhët rome, maqedonase, dhe të pakicës kombëtare të bunjevacase.

Me vendim është mundësuar që edhe pakicave që nuk kanë gazetën në gjuhën e tyre ta realizojnë këtë të drejtë, në mënyrë që këshilli kombëtar i pakicave t'i sugjerojë gazetën organit kompetent të krahinës, për botimin e të cilës kërkohet sigurimi i fondeve.

Duke zbatuar kriteret dhe kushtet e parapara, gazetën në gjuhët e pakicave bashkë-financohen nga subvencionet, ndërsa në bazë të të dhënave të ofruara nga Sekretariati Krahinor, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se me aplikimin e tyre, gazetën në gjuhët e pakicave po bashkë-financohen në sasi më të madhe se sa ato të cilat Ministria iu ka ndarë gazetave në gjuhët e pakicave kombëtare në Serbinë qendrore, e para se gjithash, kur krahasohen parametrat e numrit të shfrytëzuesve të gjuhës së pakicës kombëtare.

2. Në krahinën autonome të Vojvodinës, konkursi si mënyrë për bashkë-financim të projektit për informim publik në gjuhët e pakicave kombëtare, rregullohet me rregullore. Me inspektimin e rregulloreve për bashkë-financimin e projekteve për inkurajimin e informimit publik nëpërmjet konkursit publik, në nivel krahinor (ashtu siç është paraparë edhe në tekstin e shpalljes), thuhet që në konkurs nuk mund të marrin pjesë:

- themeluesit e medieve publike të cilët shumicën e të ardhurave e realizojnë nga abonimet apo pagesat e tjera mujore për shërbimet e tyre,
- produktet mediatike të cilat shpërndahen/transmetohen nëpërmjet medieve publike të cilët shumicën e të ardhurave e realizojnë nga abonimet apo pagesa të tjera mujore për shërbimet e tyre,
- themeluesit e medieve publike që marrin subvencione mbi ndonjë bazë tjetër nga buxheti i Krahinës Autonome të Vojvodinës.

III

² "Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës", nr. 4/08

Qeveria e RS e ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin e sistemit të Informimit Publik më 28 shtator 2011. Strategjia përcakton se mediat publike të themeluara nga këshillat nacionale të pakicave kombëtare nuk mund të marrin pjesë në konkurset e niveleve kombëtare, krahinore dhe lokale. Është pritur që kjo nënkupton se shteti ka vendosur që nëpërmjet ministrisë përkatëse, të mënjanojë dallimet e dukshme në mënyrën dhe zbatimin e masave mbrojtëse për realizimin e të drejtave të pakicave kombëtare, në nivel kombëtar dhe krahinor.

Gjegjësisht, që në rastin e gazetave, është siguruar që gazetat në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome, nga viti 2012, të bashkë-financohen nga buxheti i shtetit, **jashtë procedurave të konkursit**. Dhe në këtë mënyrë, në përputhje me pohimet e mësipërme, të mënjanohen lëshimet në punën e Ministrisë, duke marrë parasysh që është treguar se konkursi nuk është mënyra efektive për të përmbushur detyrimet e Kartës Evropiane dhe bashkë-financimit të mirëmbajtjes së gazetave në gjuhët e pakicave kombëtare në Serbinë qendrore, si dhe duke pasur parasysh se gazetat në gjuhët e pakicave kombëtare në krahinën e Vojvodinës bashkë-financohen nga subvencionet.

Megjithatë, Mbrojtësi i qytetarëve në nëntor 2011 ka pranuar letrën e të punësuarve në **NIU** "Bratstvo", të cilët e kanë informuar këtë organ se institucioni i një rëndësie të veçantë për kulturë dhe informim për qytetarët e nacionalitetit bullgar, në mungesë të fondeve, pushon së punuari dhe se gazeta "Bratstvo", gazeta e vetme për informim të qytetarëve në gjuhën bullgare në tërë territorin e Republikës së Serbisë, pas disa dekadave e pushon publikimin. Me rastin e këtij informacioni, si dhe me reduktimin e dukshëm të fondeve nga Ministria në vitin 2011 për gazetën "Bratstvo", Mbrojtësi i qytetarëve iu drejtua Ministrisë.

Ministria i është përgjigjur me shkresën e 20 janarit 2012 dhe e informoi Mbrojtësin e qytetarëve se shumica e financimit për gazetën "Bratstvo" në vitin 2011 është zvogëluar për shkak se komisioni që ka vendosur mbi projektet që kanë marrë pjesë në konkursin publik, kanë vlerësuar se shpenzimet e personelit (numri i punëtorëve) janë shumë të larta në "Bratstvo".

Në të njëjtën kohë, me këtë letër Ministria e ka informuar e Mbrojtësin e qytetarëve që, për shkak të zbatimit të Strategjisë në vitin 2012, është ndërprerë plotësisht bashkë-financimi i gazetave në gjuhët e pakicave kombëtare.

Siç është cekur, në përputhje me Strategjinë, është konstatuar orientimi i Ministrisë se fondet e destinuar për sektorin e mediave të ndahen në procedurë publike, me konkurs publik. Duke pasur parasysh se, siç thuhej më tej nga Ministria, me Strategji "vendosmërisht është theksuar që gazetat publike të themeluara nga këshillat kombëtare të pakicave nuk mund të marrin pjesë në konkurse për financimin e projektit në nivel kombëtar, krahinor dhe lokal", në buxhetin e Ministrisë për vitin 2012 "nuk janë paraparë fondet për bashkë-financim të asnjë mediumi publik në gjuhën e pakicave të themeluara nga këshillat e pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën bullgare".

Ministria nuk e ka njoftuar Mbrojtësin e qytetarëve nëse dhe në çfarë mënyre është siguruar bashkë-financimi i mëtejshëm i gazetave në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome, të cilat janë krijuar nga fondet e buxhetit të shtetit, në përputhje me detyrimet sipas Kartës Evropiane.

IV

Duke pasur parasysh se Mbrojtësi i qytetarëve në atë moment ka pasur në dispozicion të gjitha faktet relevante të paraqitura më lart për punën e Ministrisë në periudhën e kaluar, qëllimi i procedurave të mëtejshme në bazë të këtyre njohurive dhe letrës nga Ministria, është që të përcaktohet nëse këshillat kombëtare të pakicave shqiptare, boshnjake, bullgare, dhe rome dhe administrata e të drejtave të njeriut dhe të pakicave kanë qenë paraprakisht të informuar dhe të konsultuar në lidhje me ndryshimin e mënyrës së punës dhe ndërprerjes së plotë të bashkë-financimit të gazetave në gjuhët e pakicave. Dhe mbi të gjitha, nëse dhe në ç'mënyrë, është siguruar vazhdimi i mëtejshëm i bashkë-financimit para marrjes së vendimit të cekur të Ministrisë.

Në bazë të përgjigjeve të pranuar, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar se Ministria, para miratimit të Strategjisë, nuk i ka konsultuar dhe informuar këshillat e pakicave kombëtare dhe Drejtorinë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave që në vitin 2012 plotësisht të pezullohet bashkë-financimi i gazetave në gjuhët e pakicave kombëtare.

Mbrojtësi i qytetarëve pa dyshim ka konstatuar se në mënyra të tjera dhe me bazë tjetër nuk është siguruar bashkë-financimi i mëtejme me fondet e buxhetit të shtetit mirëmbajtja e gazetave në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome. Fondet e buxhetit të shtetit për këtë qëllim nuk janë siguruar edhe para miratimit dhe zbatimit të strategjisë, dhe as pas vendimit të Ministrisë që plotësisht të ndalojë bashkë-financimin.

Gazeta në gjuhën bullgare "Bratstvo" tërësisht ka ndaluar së botuari pas një veprimtarie disa dekadash. Duke pasur parasysh se këshillat nacionale kanë sasi shumë të vogla të fondeve buxhetore të parashikuara për aktivitetet në fushën e informimit, ekziston frika e arsyeshme se edhe gazeta në gjuhën shqipe, boshnjake dhe rome mund të pushojë së botuari.

Këshilli Kombëtar i pakicës shqiptare qysh nga 1 marsi 2012, e ka informuar Mbrojtësin e qytetarëve se botimi i mëtejshëm i gazetës "Nacionali", në gjuhën shqipe, është në pikëpyetje, për shkak të mungesës së fondeve. Në përgjigjen e dhënë nga Këshilli Kombëtar i pakicës boshnjake, më 13 mars 2012, është vërejtur se Ministria nuk e ka njoftuar as Këshillin as themeluesin dhe botuesin e "Sanxhaqke novine" për ndryshimet në lidhje me bashkë-financimin e botimit të rregullt të listës në gjuhën boshnjake. Edhe pse Këshilli Kombëtar nuk është themelues i "Sanxhaqke novine", siç thuhet, themeluesi i gazetës nuk ka marrë pjesë në konkursin e Ministrisë në fushën e informimit publik në gjuhët e pakicave kombëtare në vitin 2012, pasi sipas kushteve të përshkruara të drejtë për pjesëmarrje kanë pasur themeluesit e regjistruar për audio produksione dhe/ose të përmbajtjeve të programeve audio vizuale. Përveç kësaj, Këshilli informoi se me konkurs shuma maksimale e fondeve të kërkuara është 1,000,000.00 dinarë, çka mund të mbulojë vetëm shpenzimet e shtypjes për periudhën prej 6 muajve. Në mungesë të burimit të rregullt dhe të qëndrueshëm të financimit, këto gazeta e kanë ndaluar botimin e rregull që nga fillimi 2012.

Për moment, fondet e vetme buxhetore, të cilat këshillat kombëtare financiarisht e ndihmojnë mirëmbajtjen dhe botimin e gazetave në gjuhën shqipe, boshnjake dhe rome, janë fonde të pranuar nga buxheti i Republikës së Serbisë, e të cilat janë të destinuar për punën e këshillave kombëtare të pakicave.

Në fakt, në bazë të Rregullores për ndarjen e fondeve nga buxheti i Republikës së Serbisë për financimin e punës së këshillave kombëtare të pakicave, është e përcaktuar që fondet e buxhetit të shtetit të shpërndahen ashtu që 30% të ndahen në mënyrë të barabartë për këshillat e regjistruar kombëtare, ndërsa pjesa tjetër e 70% t'i ndahet proporcionalisht numrit të pjesëtarëve të pakicave (35%), sipas rezultateve të regjistrimit të fundit. 35% të mbetura ndahen në katër pjesë të barabarta në bazë të numrit të përgjithshëm dhe fushëveprimit të aktiviteteve të institucioneve të pakicave kombëtare në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe nevojave zyrtare të gjuhës dhe shkrimit, në bazë të kriterëve, standardeve dhe pikave të përcaktuara.

Mbi këtë bazë, përcaktohet shuma e fondeve buxhetore, ndërsa në bazë të kriterit për mediet e shtypura, është numri i gazetave, sipas periudhës së botimit dhe nëse është në gjuhën e pakicës apo dygjuhësh/shumëgjuhësh dhe për secilin kriter është paraparë numri i pikave (p.sh., gazeta ditore - 70 pikë, gazeta javore - 50 pikë, mujore - 25 pikë). Kështu, përveç që këto mjete buxhetore janë paraparë për punën e këshillit kombëtar, dhe jo për bashkë-financimin e realizimit të të drejtave të pakicave në fushën e informimit, të ardhurat e fondeve të buxhetit për informim, të llogaritur në bazë të Rregullores, janë shumë të vogla.

Nga të gjitha këto arsye, si dhe duke pasur parasysh që paraprakisht nuk është siguruar bashkë-financimi i gazetave nga fondet buxhetore në pjesë të konsiderueshme ose mbizotëruese, mbi baza

të tjera, zbatimi i strategjisë në pjesën ku iu ndalohet gazetave të themeluara nga këshillat kombëtare për të marrë pjesë në konkursin publik të shpallur nga Ministria, dhe vendimi i Ministrisë që për këtë të pezullojë plotësisht bashkë-financimin e gazetave në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome është i paligjshëm dhe i parregullt. Pasi që gazetat në krahinën autonome të Vojvodinës bashkë-financohen gazetat nga subvencionet, është shkelur e drejta që *garanton status të barabartë dhe mbrojtjen ligjore të të gjitha pakicave kombëtare.*

Zbatimi i strategjisë dhe ndalimi i pjesëmarrjes në konkursin publik të shpallur nga Ministria edhe mediave të tjera publike (radio, TV, publikimeve në internet) themeluesit e të cilëve janë Këshillat Kombëtare, është gjithashtu jolegal nëse paraprakisht nuk sigurohet bashkë-financimi i tyre me fondet buxhetore nga bazat tjera, sepse bëhet dallimi në qasjen e mbrojtjes dhe ushtrimit të të drejtave në bazë të asaj nëse themeluesi i gazetës publike është këshilli kombëtar i pakicave apo person tjetër fizik ose juridik.

Përveç kësaj, strategjia, ashtu siç është definuar, nuk aplikohet në Krahinën autonome të Vojvodinës, sepse gazetat në gjuhët e pakicave bashkë-financohen nga subvencionet, dhe siç u përmend tashmë, sipas rregullores dhe tekstit të përcaktuar saktësisht në konkurs, për shkak të të cilave as gazetat e tjera publike (pavarësisht se kush është themelues) nuk mund të marrin pjesë në konkurs.

Dhe së fundi, me ndërprerjen e botimit të gazetave në gjuhën bullgare dhe ndalimit eventual të botimit të gazetave në gjuhën shqipe, boshnjake dhe rome, me mungesë të mbështetjes financiare të buxhetit të shtetit, pasojat janë:

- se një numri të konsiderueshëm të qytetarëve u rrezikohet e drejta e informimit në gjuhën e tyre, sepse me shpërndarjen e gazetave në gjuhët e pakicave kombëtare në gjithë territorin e Republikës së Serbisë iu sigurohet edhe qytetarëve të cilët nuk kanë qasje në programet lokale dhe stacionet rajonale të radio e TV në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome;

- se janë shkelur të drejtat e pakicave shqiptare, boshnjake, bullgare dhe rome sepse niveli i arritur i të drejtave nuk mund të reduktohet, dhe

- se Republika e Serbisë, i përmbush detyrimet e pranuar sipas Kartës Evropiane vetëm në një pjesë të territorit të saj, në Krahinën autonome të Vojvodinës, dhe jo për të gjitha gjuhët.

Përndryshe, Ministria nuk i ka mbështetur as konkluzionet e deputetëve të cilët e kanë ngritur iniciativën gjatë dëgjimit publik për draftin e Strategjisë, më 14 korrik 2011, në të cilën ndër të tjera, në pikën 4 është cekur pikëpamja e tyre "që shteti duhet të marrë përsipër përgjegjësinë e financimit buxhetor për botimin e një mediumi në gjuhën e secilit komunitet në Serbi".

E drejta për informim në gjuhën amtare, përveç shkollimit në gjuhën amtare, është më e rëndësishme për ruajtjen e identitetit etno - kulturor të pakicave kombëtare. Mbrojtja e të drejtës në informim në gjuhën e pakicës është e garantuar me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar. Shteti, si garantues i të drejtave të njeriut dhe të pakicave është i detyruar, përveç aktiviteteve legjislative, që përmes ministrive përkatëse dhe organeve tjera publike, të sigurojë zbatimin e masave, veçanërisht financiare, për të siguruar mbrojtje të barabartë dhe ushtrimin e të drejtës për informim për të gjitha nacionalitete në tërë territorin e Republikës së Serbisë.

Mirëmbajtja e të paktën një gazete në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare dhe rome, si dhe krijimi dhe mirëmbajtja e gazetave në gjuhë të tjera të pakicave kombëtare që këtë të drejtë nuk e kanë realizuar, nënkupton mbështetjen e vazhdueshme të buxhetit të shtetit, jashtë procedurave të konkursit. Dhe atë në bazë të parametrave paraprakisht të paracaktuara qysh në fillim të vitit buxhetor, në mënyrë që botimi i gazetave të jetë i rregullt, dhe të sigurohet pavarësia e politikës rregulluese dhe botimi i gazetave në përputhje me të gjitha standardet profesionale dhe mënyrë që aktivitetet e botuesve mund të planifikohen. Prandaj është e nevojshme që Ministria të rregullojë këtë fushë sipas përvojave dhe standardeve të aplikuar në krahinën autonome të Vojvodinës, si dhe në procesin e hartimit dhe miratimit të një vendimi të

tillë t'i përfshijë edhe këshillat nacionale të pakicave kombëtare dhe Departamentin e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave.

V

Me këtë rast duhet përkujtuar Ministrinë edhe publikun që në vitin 2009 në procedurë sipas ankesës nga institucioni gazetar-botues "Bratstvo", e themeluar për të realizuar aktivitetet e botimit informativ në gjuhën bullgare, Mbrojtësi i qytetarëve ka konstatuar mangësitë në punë dhe i ka dërguar Ministrisë së Kulturës një rekomandim për t'i rregulluar ato. Atëherë Ministria ka pohuar se është siguruar vazhdimi i ushtrimit të të drejtave për mbështetje në fushën e informimit (gazeta "Bratstvo"), bazuar në kriteret e përcaktuara rishtazi, që përfshijnë kostot e printimit, kostot e shpërndarjes dhe pagat (deri në 10 varësisht prej vëllimit të listës), në bazë të cilave janë marrë vendimet për shpërndarjen e fondeve vjetore për të gjitha listat në gjuhët e pakicave, të cilat financohen nga buxheti i Ministrisë. Duke pasur parasysh një deklaratë të tillë të Ministrisë, Mbrojtësi i qytetarëve i ka dorëzuar Ministrisë një rekomandim për të përcaktuar mënyrën dhe kriteret për bashkë-financimin e aktiviteteve botuese NIU "Bratstvo" në gjuhën bullgare, në përputhje me ligjet në fuqi dhe fondet e buxhetit në dispozicion.

Ministria nuk ka vepruar sipas rekomandimit e në lidhje me rekomandimin e ka njoftuar Mbrojtësin e qytetarëve se mbështetja për botimet sigurohet nëpërmjet konkursit në fushën e krijimtarisë kulturore, në të cilin në kushte dhe të drejta të barabarta mund të marrin pjesë edhe NIU "Bratstvo".

Ministria atëherë ka pohuar se ka marrë dhe do të marrë të gjitha masat brenda kompetencave të saj që të ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arritur të të drejtave të pakicave. Megjithatë, jo vetëm që nuk është ruajtur niveli i arritur i të drejtave, por në të kundërtën, në periudhat pasuese, Ministria çdo vit e ka ndryshuar mënyrën e bashkë-financimit dhe në fund krejtësisht e ka ndaluar mbështetjen e buxhetit të shtetit për mirëmbajtjen dhe botimin e rregullt të gazetave, si në gjuhën bullgare, ashtu edhe shqiptare, boshnjake dhe rome.

Në rekomandim gjithashtu është vënë në pah edhe qëndrimi i Mbrojtësit të qytetarëve i cili konsideron, që përveç detyrimeve ligjore, në situata ku është e nevojshme për të ndryshuar metodat e përcaktuara më parë të punës dhe të bashkëpunimit, organi administrativ duhet të konsultohet me palët e interesit. Megjithatë, duke marrë parasysh faktet e paraqitur më lartë, Ministria edhe në vitet pasuese ka vazhduar punën me të gjitha karakteristikat e një qeverisjeje të keqe, në kundërshtim me obligimet ligjore, merr vendimet arbitrare për të cilat nuk njofton dhe nuk konsulton këshillat kombëtare të pakicave.

VI

Me rastin e vendosjes për këtë çështje, Mbrojtësi i qytetarëve ka pasur parasysh se është obligimi i organit përkatës që në punën e tyre t'i përmbahet Kushtetutës, ligjeve dhe rregullave e rregulloreve ndërkombëtare, dhe atë:

Kushtetuta e Republikës së Serbisë garanton se çdokush e ka të drejtën në mbrojtje të barabartë ligjore (neni 21) dhe pakicave kombëtare i garantohet barazia para ligjit dhe mbrojtja e barabartë ligjore (neni 76).

Përveç kapitujve me të cilat janë të rregulluara të drejtat shtesë të pakicave kombëtare, me dispozitën e nenit 48 të Kushtetutës, është e paraparë në mënyrë të veçantë detyrimi që me masat në arsim, kulturë dhe informim publik, Republika e Serbisë të nxis mirëkuptim, vlerësim dhe respekt për dallimet që rrjedhin nga identiteti specifik etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar për qytetarët e saj.

Me Konventën Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare në nenin 5 është e paraparë dispozita e përgjithshme me të cilën Shtetet anëtare obligohen të krijojnë kushtet e nevojshme për personat që i përkasin pakicave kombëtare për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore.

Gjithashtu, shteti është i obliguar që të miratojë masat e duhura, duke përfshirë financiare, për personat që i përkasin pakicave kombëtare t'i lehtësohet qasja në media, me qëllim të rritjes së tolerancës dhe mundësimi i pluralizmit kulturor.

Me Ratifikimin e Kartës Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave, Republika e Serbisë e ka marrë përgjegjësinë që për gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare, hungareze, rome, rumune, ruse, sllovaqe, ukrainase dhe angleze, në përputhje me nenin 11 në lidhje me mjetet e informimit publik, paragrafi 1 pika e (i), të nxis ose lehtësojë krijimin dhe mirëmbajtjen e të paktën një gazete në gjuhët rajonale ose minoritare.

Në përputhje me dispozitat e nenit 17 Ligji për ministritë, Ministria e kulturës, informimit dhe shoqërisë informative kryen punët e administratës shtetërore të cilat ndër të tjera kanë të bëjnë edhe me sistemin e informimit publik, monitorimin e zbatimit të ligjeve në fushën e informimit publik dhe informimit të pakicave kombëtare.

Me ligjin për informim publik në nenin 5 është konstatuar që për të drejtat e pakicave kombëtare dhe komuniteteve etnike për informim në gjuhën e tyre dhe nxitjen e kulturës dhe identitetit të tyre, Republika, krahina autonome, gjegjësisht pushteti lokal e siguron një pjesë të mjeteve ose kushtet tjera për punë të gazetave publike në gjuhën e pakicave.

Në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të vërtetuara, Mbrojtësi i qytetarëve, në përputhje me nenin 31, paragrafi 2 i Ligjit për Mbrojtësin e qytetarëve, i ka dorëzuar rekomandimet Ministrisë së kulturës, informimit dhe shoqërisë së informacionit, me qëllim të mënjanimin të mangësive, mbrojtjes të barabartë dhe ushtrimit të të drejtave të pakicave kombëtare në fushën e informimit dhe mbrojtje të barabartë ligjore për të gjitha gjuhët e pakicave në Republikën e Serbisë, përmirësimin e punës së organit administrativ dhe parandalimin e lëshimeve të ngjashme në të ardhmen.

ZËVENDËSI I MBROJTËSIT TË QYTETARËVE

dr Goran Bašić

T'i paraqitet për informim:

- Këshillit nacional të pakicës kombëtare shqiptare,
- Këshillit nacional të pakicës kombëtare boshnjake
- Këshilli nacional të pakicës kombëtare bullgare
- Këshillit nacional të pakicës kombëtare rome
- Departamentit për të drejtat e njeriut dhe të pakicave